



Republika e Kosovës – Republika Kosova  
Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa  
Izborni Panel za Žalbe i Predstavke

A nr. 254/2013

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa (PZAP), në panelin e përbërë nga gjyqtarët: Muhamet Rexha kryesues, Hasan Shala dhe Ferit Osmani anëtarë, duke vendosur përkitazi me ankesën e subjektit politik Srpska Liberalna Stranka (SLS) dega në Graçanicë, paraqitur kundër subjektit politik Savez Kosovskih Srbë (SKS) dega në Graçanicë, për shkak të dëmtimit të posterave dhe bilbordeve, në seancën e panelit të mbajtur me 25.10.2013, mori këtë:

#### VENDIM

**Refuzohet** si e pabazuar ankesa e Srpska Liberalna Stranka (SLS), dega në Graçanicë.

#### Arsyetim

PZAP-i, ka pranuar një ankesë më datë 12.10.2013, nga subjekti politik SLS dega në Graçanicë, më të cilën theksohet se me datën 08.10.2013 dhe 11.10.2013 përkrahësit e subjektit politik SKS kane dëmtuar billbordet e SLS në Graçanicë ndersa me datën 06.10.2013 kanë dëmtuar posterat dhe materialin zgjedhor në zyrat e SLS ne fshatin Dobratin dhe ne fshatin Livagje. Me këtë rast parashtruesi i ankesës thekson se subjekti politik SKS ka shkelur rregullat zgjedhore 11/2013 dhe 13/2013dhe si dëshmi ka bashkangjitur disa fotografji.

PZAP-i, e informoi subjektin politik SKS në kuptim të nenit 4 paragrafi 3 të Rregullave dhe Procedurave të PZAP-it, më datë 17.10.2013, për ankesën që është bërë ndaj këtij subjekti politik dhe ka kërkuar që të përgjigjet ndaj ankesës deri më datë 18.10.2013, më ora 12:00. Sipas afatit të caktuar, PZAP-i, pranoi përgjigjen e kërkuar nga subjekti politik SKS ku mes të tjerash thekson se këto janë vetëm supozime dhe se nuk ka asnë fakt dhe me këtë rast aktivistet e SKS nuk kane kurfar lidhje me këtë ngjarje dhe se këto raste i konsiderojnë si provokim dhe se te gjitha dëmtimet janë bere nga subjektet e ndryshme politike me qellim që këto veprime të ja përshkruajnë SKS.

PZAP-i, pasi që shqyrtoj ankesën gjeti se:

## Ankesa është e pabazuar

Pretendimet e ankuesit në ankesën e tij se anëtarët e subjekti politik SKS kanë dëmtuar posterat dhe bilbordet e SLS, PZAP-i i vlerëson si të përgjitheshme dhe të pa argumentuara në prova dhe në dëshmi bindëse, dhe se një ankesë e tillë është e pa bazuar, prandaj në kuptim të nenit 115.1 lidhur me 118 paragrafi 1 të LZP-së, lidhur me ankesën e lart përmendor u vendos si në dispozitiv të këtij vendimi.

### Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresë

Anr. 254/2013 më datën 25.10.2013

Kryesuesi i Panelit  
Muhamet Rexha



#### ***Udhëzim Juridik:***

PZAP nuk do t'i pranojë kërkesat për ri-apelim, sepse vendimet e tij do të konsiderohen si përfundimtare. Prandaj, siç parashihet në Nenin 118.4 të LZP-së, ankesa në Gjykatën Supreme të Kosovës mund të paraqitet brenda njëzetekatër (24) orëve nga momenti i marrjes së vendimit nga PZAP-i, në rast se gjoba e përfshirë është më e lartë sesa pesëmijë (5, 000) Euro ose në rast se çështja prek një të drejtë themelore